

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Oligarkët rusë, gjithnjë e më të pasur dhe më të frikësuar nën zgjedhën e Putinit: Shteti mund të marrë kontrollin e kompanive tuaja, nëse nuk jeni në gjendje t'i mbrojnë!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/oligarket-ruse-gjithnje-e-me-te-pasur-dhe-me-te-frikesuar-nen-zgjedhen-e-pu-i584381
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 19:23:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 20:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	360f601cae9c4ed375a104799322bbb31aab2dcfa51cd76e9be5719053ddf159
TEKSTI	e13b914740f12c9698a79e175046cb900990a4fb5792d679c1777e0ca246b47a
PAMJA	57f24ae82403f744f451698f11c1674f5c09e6ee7297fdb3369f33eb7ae55f4a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	319d6808225ec85350beb69c85673eba4d567a3cc29a148674a9a939335c1bb9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3909e366fa48fb117e93d2c07d0f8b111d83fbadbc5fe5fb3b2f1229006811f8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/319d6808225ec85350beb69c85673eba4d567a3cc29a148674a9a939335c1bb9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e Dita e 96-të e protestës, organizatorët paralajmërojnë tubim para Parlamentit më 8 shtatorShkencetaret në Kinë zbulojnë virus të ri: Shkakton simptoma të ngjashme me gripinNetanjahu: Fundi i r fundit

Oligarkët rusë, gjithnjë e më të pasur dhe më të frikësuar nën zgjedhën e Putinit: Shteti mund të marrë kontrollin e kompanive tuaja, nëse nuk jeni në gjendje t'i mbron!

6 Shtator 2026, 22:05Bota TEMA



Oligarkët rusë, gjithnjë e më të pasur dhe më

Oligarkët në Rusi po i ngjajnë gjeteve të vjeshtës. Vladimir Putin sapo ka firmosur një dekret që u lejon autoriteteve të “marrin përkohësisht nën kontroll infrastrukturën me rëndësi kritike, nëse pronarët e saj nuk janë në gjendje ta mbrojnë nga sulmet me dronë”.

Me fjalë të tjera, nëse rafineritë e naftës, depot e gazit apo, në përgjithësi, kompanitë që merren me energjinë, komunikimet, transportin, logjistikën dhe nxjerrjen e lëndëve të para goditen nga sulmet ukrainase, ato mund të konfiskohen dhe të kalojnë nën kontrollin e qeverisë.

“Mbrojtja më e mirë e mundshme është administrimi shtetëror”, shkroi një gazetë.

Por si mund të ndihet një multimiliarder që ia detyron pasurinë pikërisht shtetit dhe liberalizimeve të çmendura të viteve '90, kur tani shteti – ose më saktë njeriu që ka kontroll absolut mbi të – deklaron publikisht se mund t'ia marrë gjithçka mbrapsht, duke shfrytëzuar një emergjencë të paparashikueshme si një sulm nga ajri?

Askush nuk do të derdhë lot për peshkaqenët e ekonomisë ruse, ata që në Bashkimin Sovjetik do të quheshin “peshkaqenët e imperializmit”, term që përdorej dikur për miliarderët përendimorë. Aq më tepër që nuk po jetojnë aspak keq.

Sipas të dhënave më të fundit të Bloomberg Billionaires Index, pasuria e përgjithshme e rusëve më të pasur është rritur sërish gjatë gjysmës së parë të vitit 2026.

Aleksei Mordashov, themeluesi i Severstal, gjigant i industrisë së çelikut, e ka çuar pasurinë e tij në 28.6 miliardë dollarë. Vladimir Potanin, presidenti i Norilsk Nickel, një minierë e vërtetë pasurie me metale të rralla, zotëron 25.1 miliardë dollarë.

Leonid Mikhelson, kreu i Novatek – kompania e dytë më e madhe ruse e gazit pas Gazprom – ka arritur në 25.5 miliardë dollarë, ndërsa Andrei Melnichenko, themeluesi i EuroChem, në sektorin e plehrave kimike, dhe Suek, që operon në qymyr, prodhimin e energjisë elektrike, infrastrukturë dhe porte, zotëron 20.6 miliardë dollarë.

Pasuria e Gennady Timchenkos, mik i Putinit dhe pronar i Volga Group, që investon dhe zotëron aksione të mëdha në kompani të naftës dhe gazit, transportit hekurudhor, qymyrit dhe ndërtimit industrial, vlerësohet në 15.4 miliardë dollarë.

Iskander Makhmudov, themelues i UMMC, kompanisë minerare dhe metalurgjike të Uraleve, zotëron rreth 8.6 miliardë dollarë. Pasuria e Mikhail Fridman, pronar i Alfa Group, kryesisht aktiv në sektorin bankar, është rritur në 10.7 miliardë dollarë, ndërsa ajo e Suleiman Kerimov, i lidhur me sektorin e arit, ka arritur në 11 miliardë dollarë.

Tatiana Kim, aksionerja më e madhe e Wildberries, platforma më e madhe ruse e shitjeve online, zotëron rreth 8.3 miliardë dollarë. Kompania e saj ka pësuar dëme të mëdha gjatë sulmeve të fundit ukrainase me dronë ndaj depove në disa rajone të Rusisë.

Një rënie e lehtë e pasurisë së tyre të përgjithshme gjatë katër muajve të fundit nuk e ndryshon panoramën. Të gjithë janë kthyer në Rusi dhe vazhdojnë të jetojnë mjaft mirë, ndërsa 20 shtetas rusë renditen mes 500 njerëzve më të pasur në botë.

Ndryshim kursi

Megjithatë, siç dihet, edhe burgjet mund të jenë prej ari.

Pak ditë më parë, faqja ekonomike profinance.ru shkruante: “Gjatë vitit të fundit, disa prej qytetarëve më të pasur të Rusisë, përfshirë persona të afërt me presidentin Vladimir Putin, kanë transferuar miliarda dollarë jashtë vendit. Shkak është bërë shqetësimi i tyre për gjendjen ekonomike të vendit dhe financat e shtetit. Rastet gjithnjë e më të shpeshta të konfiskimit të pasurive kanë shtuar frikën e elitës se mund t'u sekuestrohen pronat ose të humbasin kursimet.”

Disa miliardërë i kanë zhvendosur së fundmi pasuritë e tyre jashtë Rusisë për shkak të shqetësimeve lidhur me sektorin bankar. Burimet thonë se gjatë vitit të fundit disa prej njerëzve më të pasur të vendit kanë ndryshuar mënyrën se si i kanë shpërndarë investimet e tyre. Në muajt e fundit ky proces është përsheptuar.

Tani ata preferojnë të investojnë në kriptomonedha, ar, prona jashtë Rusisë dhe fonde private investimesh, veçanërisht në vendet e Gjirit Persik.

Janë lëvizje të kufizuara dhe kryhen me shumë kujdes, nga frika e hakmarrjes, e cila mund të jetë drastike. Dihet se Kremlin i nuk shquhet për gjysmëmasa.

Ndjesinë e pasigurisë nuk e zbuti as takimi që industrialistët kryesorë rusë zhvilluan me Putinin marsin e kaluar. Gjatë tij, oligarku besnik Suleiman Kerimov propozoi një kontribut “vullnetar” – thonjëzat këtu janë të domosdoshme – për të ndihmuar ekonominë që po kalon vështirësi.

Pas nisjes së luftës në shkurt 2022, e cila solli një përqendrim drastik të marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën, sanksionet ndërkombëtare detyruan pothuajse të gjithë oligarkët të rikthenin pasuritë e tyre në Rusi dhe të transferonin atje selitë e kompanive.

Shumë prej tyre panë t'u ngrinin pasuritë që zotëronin jashtë vendit.

Edhe biznesmenët që kishin guxuar të mbanin një distancë, sado të vogël, nga pushtimi i Ukrainës, si Fridman dhe “mbreti i aluminit” Oleg Deripaska, u detyruan të bënin një kthim poshtërues, me kokën ulur. Deripaska madje u shndërrua në një skifter. Por, pasi u kthyen brenda Rusisë, të gjithë u përballën me rreziqe të reja.

Pa alternativa

Duke nisur nga viti 2024, autoritetet ruse filluan operacione në shkallë të gjerë për konfiskimin e pasurive, të drejtuara kundër atyre që ishin përpjekur të ruanin lidhjet me botën e jashtme, përfshirë edhe përmes shtetësisë së dyfishtë.

Alternativat ishin thujse inekzistente.

Fridman, i cili kishte qenë mik dhe financues i Boris Nemtsov, kundërshtarit të Putinit të vrarë më 27 shkurt 2015, ka treguar gjatë një takimi privat për poshtërimin që kishte përjetuar kur, gjatë një kontrolli në shtëpinë e tij në Londër, ishte vënë në pranga dhe ishte shtrirë për tokë përpara familjarëve dhe punonjësve të tij.

Në një intervistë për Financial Times, Piotr Aven, i cili në atë kohë gjithashtu jetonte në Angli, tregoi se llogaritë bankare iu bllokuan nga njëra ditë në tjetrën, deri në atë pikë sa iu desh t'i kërkonte para një miku për të paguar mësuesit mbështetës të djalit të tij autik.

Nuk mund të qëndronin më. U detyruan të largoheshin.

Tani, megjithatë, diçka po ndryshon. Mes elitave evropiane po fiton terren ideja se ka ardhur koha t'u bëhet e qartë oligarkëve se mund të bëjnë edhe pa Vladimir Putinin, duke i nxitur që t'i rikthejnë kapitalet e tyre jashtë Rusisë dhe, në njëfarë mënyre, të kthehen edhe vetë.

Por në Rusinë e sotme, e cila vështirë se mund të quhet një vend normal e aq më pak një demokraci, një zgjedhje e tillë do të konsiderohej dezertim.

Me të gjitha pasojat që mund të sillte kjo.

Të përcëmuar në atdhe, ndërsa tani deri diku të dëshiruar sërish jashtë tij: oligarkët rusë mbeten, sidoqoftë, gjithmonë në mëshirën e Putinit. /CorrieredellaSera

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Netanjahu: Fundi i regjimit në Iran është afër](#)

20:55 Bota / 1 koment

[Zgjedhje që mund të ndryshojnë politikën gjermane, AfD fiton bindshëm në Saksoni-Anhalt](#)

19:35 Bota / 3 komente

[Kushner dhe Witkoff bisedime me Zelenskyn në Kiev: Ishte një diskutim i rëndësishëm për afrimin e fundit të luftës](#)

18:45 Bota / 2 komente

[Shembet ndërtesa 5-katëshe në New Dehli, 3 viktima dhe 8 të plagosur, nis operacioni për shpëtimin e të bllokuarve](#)

18:25 Bota

[Von der Leyen viziton Groenlandën, BE rrit mbështetjen ndaj ishullit](#)

18:05 Bota / 1 koment

[Përplasje në Cernobbio/ Vannacci kërkon frenimin e integritetit evropian: BE të jetë platformë bashkëpunimi, jo detyrimi](#)

17:45 Bota

[Turqia kërkon uljen e tensioneve mes SHBA-së dhe Iranit, Erdogan: Do të vijojmë iniciativat për paqe](#)

17:35 Bota

[Udhëtoni drejt BE-së? Nga 6 shtatori kontrollet biometrike mund të zgjasin pritjet në kufi](#)

17:15 Bota

[Nga oligarkët te familja Orbán, qeveria e re e Hungarisë nis hetimin për pasuritë e përfituara padrejtësisht](#)

17:05 Bota / 1 koment

[Shpërthen vullkani në Indonezi, pezullohen 209 fluturime dhe bllokohen mijëra pasagjerë](#)

16:35 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikë...](#)

12:25 Politika / 94 komente

[Shkon për vetulla, por gjen protesta - Meçe: Sali Berishë...](#)

20:55 Politika / 18 komente

[Rama përballë 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasard...](#)

08:45 Politika / 49 komente

[Pronat para viteve '91/ Kadastra hap aplikimin online, pë...](#)

14:25 Sociale /4 komente

[“Pushteti është një kafshë e përbindshme” - Rama për Ilir..](#)

15:25 Politika /44 komente

Blog Tema

[Pritja e qytetarëve nga titullarët, formalitet apo detyrim?](#)

19:35 Blog

[Vetëm 8% probabiliteti në Polymarket për rënien e qeverisë Rama këtë vit...](#)

11:03 Blog

[GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës!](#)

10:05 Blog /12 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by